

LIGJ
Nr. 110/2014

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË
HUAS DHE ASISTENCËS TEKNIKE
(GRANT) NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS ISLAMIKE PËR
ZHVILLIM (IDB) PËR PJESËMARRJE NË
FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
MIKROFINANCËS NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas dhe asistencës teknike (grant) ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB) për pjesëmarrje në financimin e projektit të mikrofinancës në Shqipëri, nëpërmjet një kredie prej 1 000 000 USD (një milion dollarësh amerikanë), një kredie prej 2 670 000 ID (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë dinarësh islamikë) dhe një granti prej 200 000 ID (dyqind mijë dinarësh islamikë).

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.7.2014

Shpallur me dekreten nr. 8692, datë 22.8.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Nr. i Projektit: ALB-30-31-32

**MARRËVESHJE HUAJE DHE ASISTENCE
TEKNIKE (GRANTI)**

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
ISLAMIKE PËR ZHVILLIM (NË CILËSINË E

SAJ DHE SI ADMINISTRATORE E FONDIT
ISLAMIK TË SOLIDARITETIT PËR ZHVILLIM)
PËR PJESËMARRJE NË FINANCIMIN E
PROJEKTIT TË MIKROFINANCËS NË
SHQIPËRI

\\IDBSRV1\idb\230149\FAgrts\Loan+TA\ALB-30-31-32(LN+ISFDLN+TAG).docx
1/30/2019 9:33 paradite//DD

Kjo Marrëveshje lidhet me ____/____/1434H që përputhet me ____/____/2013G, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (më poshtë quhet “Marrësi”) dhe Bankës Islamike për Zhvillim (më poshtë quhet “IDB”) që vepron në cilësinë e saj dhe në cilësinë si administratore e Fondit Islamik të Solidaritetit për Zhvillimin (më poshtë e quajtur “ISFD” (ISFD dhe IDB së bashku quhen ISFD).

Marrësi dhe ISFD-ja individualisht quhen “Pala” dhe së bashku “Palët”.

Duke marrë në konsideratë se:

A. Marrësi ka kërkuar asistencën e ISFD-së në financimin e një projekti mikrofinancë të përshkruar në aneksin I (më poshtë quhet “Projekti”) nëpërmjet dhënies së një huaje Marrësit që do t’ia kalojë një Partneri Mikrofinancë, i cili do t’i japë mikrohua Përfituesve Fundorë, siç parashikohet më poshtë;

B. Një prej qëllimeve të IDB-së është të asistojë vendet e saj anëtare nëpërmjet dhënies së huave për financimin e projekteve dhe programeve prodhuese;

C. ISFD-ja, e krijuar si një fond i veçantë i IDB-së, ka si qëllim financimin e projekteve dhe programeve të ndryshme që ndihmojnë në uljen e varfërisë në vendet anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike;

D. Projekti konsiderohet të jetë teknikisht i qëndrueshëm dhe ekonomikisht i justifikuar;

E. ISFD-ja ka rënë dakord, ndërmjet të tjerash, në bazë të sa më sipër t’i japë Marrësit një hua me termat dhe kushtet e parashikuara më poshtë;

F. ISFD-ja ka rënë dakord gjithashtu t’i japë Marrësit një grant asistence teknike për të ndihmuar në fuqizimin e kapacitetit të Partnerit të Mikrofinancës për të përdorur produktet e mikrofinancës në përputhje me Shari’ah, si dhe të trajtojë kufizimet e tij organizative, operacionale dhe të kapaciteteve,

kështu, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Kushte të përgjithshme, përkufizime

1.1 Kushte të përgjithshme. Palët pranojnë të gjitha dispozitat e Kushteve të Përgjithshme që zbatohen për Marrëveshjet e huas dhe garancisë të IDB-së në datën 8.11.1976 (më poshtë të quajtur si “Kushte të Përgjithshme”) me të njëjtën fuqi dhe efekt sikur të ishin parashikuar këtu.

1.2 Përkufizime: Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përkufizuara në Kushtet e Përgjithshme kanë

kuptimet përkatëse të parashikuara atje dhe termat e mëposhtme shtesë kanë kuptimet e mëposhtme:

“Procedurë Livrimi”: procedura e livrimit e IDB-së.

“Livrimi”: tërheqja e Huas dhe Grantit.

“Datë e Hyrjes në Fuqi”: data në të cilën Marrëveshja deklarohet në fuqi nga ISFD-ja siç i komunikohet Marrësit nga ISFD-ja.

“Përfitues Fundorë”: individë, grupe dhe mikrosipërmarrës ruralë të identifikuar në fushat e mbuluara nga Projekti.

“Raste të mospërmblidhjes së detyrimeve”: një prej rasteve të përmendura në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje.

“Granti”: shuma që IDB-ja ka rënë dakord ti japë Marrësit sipas specifikimit në seksionin 2.1(ii)(b) për ndërtimin e kapaciteteve të Partnerit të Mikrofinancës që transferohet si grant nga Marrësi të Partneri i Mikrofinancës.

“Vendet Anëtare të IDB-së”: vendet që kanë nënshkruar ose ratifikuar nenet e Marrëveshjes së IDB-së.

“IDB”: Banka Islamike për Zhvillim.

“Politikat dhe Udhëzimet Operacionale të ISFD-së”: Udhëzimet operacionale të politikave për Fondin Islamik të Solidaritetit për Zhvillim, të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve (nr. ISFD/1429H/BOD/02/(6)) në vitin 2008G. Politikat dhe udhëzimet kanë prioritet për programet/projektet e financuara nga ISFD-ja. Në rastin e një boshllëku në politikat dhe udhëzimet operacionale, zbatohen politikat dhe udhëzimet përkatëse të IDB-së.

“Dinar islamik/ID”: sipas përkufizimit në nenin 4(1)(a) të Marrëveshjes që themelon IDB, është njësia e llogarive të IDB-së. Një dinar islamik është i barabartë me Një të Drejtë të Veçantë Tërheqjeje SDR të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

“Hua”: shumat që IDB-ja dhe ISFD-ja kanë rënë dakord t'i huazojnë Marrësit sipas specifikimit në seksionin 2.01(i) dhe seksionin 2.01(ii)(a), për t'iu nënhuazuar me të njëjtat kushte nga Marrësi Partnerit të Mikrofinancës.

“Partner i Mikrofinancës”: është Shoqëria e Parë Shqiptare Financiare për Zhvillim, e cila është përgjegjëse për zbatimin e Projektit për dhe në emër të Marrësit.

Marrëveshje e Mikrohuadhënies: Marrëveshja e mikrohuadhënies për t'iu nënshkruar ndërmjet Partnerit të Mikrofinancës dhe Përfituesve Fundorë në lidhje me përdorimin e shumave të Huas për qëllimet e Projektit.

“Efekt Material Negativ”: është efekti material negativ që ka lindur si rezultat i një situate të tillë që:

a) sipas mendimit të Bankës e bën të pamundur që Marrësi të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, ose

b) pengon arritjen e qëllimeve për të cilat është

lidhur kjo Marrëveshje.

“Marrëveshja e Nënhuadhënies”: Marrëveshja e nënhuas që do të nënshkruhet ndërmjet Marrësit, nëpërmjet Ministrit të Financave, dhe Partnerit të Mikrofinancës në lidhje me përdorimin e shumave të Huas.

“Shuma Principale”: Huaja faktikisht e tërhequr nga Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, në pajtim me këtë Marrëveshje.

“Udhëzimet e Prokurimit”: Udhëzimet për Prokurimin e Mallrave dhe Shërbimeve sipas Financimit të ISFD-së, ose në mungesë të saj Udhëzimet e IDB-së për Prokurimin e Mallrave dhe Punëve.

“Projekti”: Projekti dhe pjesët e tij të përshkruara në aneksin I të kësaj Marrëveshjeje.

“Tarifa e Shërbimit”: tarifa e pagueshme nga Marrësi ISFD-së sipas specifikimit të seksionit 4.2.

“USD” ose “US\$”: Monedha e ligjshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Neni 2

Huaja dhe granti i asistencës teknike

2.1 Huaja dhe Granti i jepet Marrësit si më poshtë:

i) ISFD-ja i jep Marrësit një hua në një shumë që nuk kalon 1,000,000 USD (një milion dollarë amerikanë) afërsisht ekuivalenti i ID 667,000/- (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë dinarë islamikë) (“Huaja e ISFD-së”).

ii) IDB-ja i jep Marrësit:

a) Një hua që nuk kalon ID 2,670,000/- (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë dinarë islamikë) afërsisht ekuivalenti i US\$ 4,000,000.00 (katër milionë dollarë amerikanë) (“Huaja e IDB-së”); dhe

b) Një grant të asistencës teknike në një shumë që nuk kalon ID 200,000.00 (dyqind mijë dinarë islamikë) afërsisht ekuivalenti i 300,000.00 US \$ (treqind mijë dollarë amerikanë) (“Granti”).

2.2 Prokurimi i Mallrave dhe Shërbimeve: Përveç kur ISFD-ja bie dakord ndryshe me shkrim, kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga shumat e kësaj Huaje dhe Grantit të dhënë prokurohen në pajtim me Udhëzimet e Prokurimit dhe parimet e Shari’ah-ut Islamik. Në këtë aspekt, Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës respekton Rregulloret e Bojkotit të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik.

2.3 Disponibiliteti i shumës së Huas dhe Grantit u nënshtrohet, sipas mendimit të prerë të ISFD-së, rasteve të mëposhtme:

(i) Efekt Material Negativ nuk ka ndodhur dhe nuk është duke vazhduar;

(ii) Rasti i Mospërmblidhjes së Detyrimeve nuk ka ndodhur dhe nuk është duke vazhduar.

Neni 3

Tërheqjet dhe përdorimi i shumave të huas dhe

grantit të asistencës teknike

3.1 Tërheqjet: Huaja dhe Granti i dhënë nga ISFD-ja mund të tërhiqet nga Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, në pajtim me aneksin III dhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje, Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurën e Disbursimit, për qëllimet e parashikuara në këtë Marrëveshje, për shpenzimet e kryera në lidhje me koston e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Data e Kërkimit të Livrimit të Parë: Nëse brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga Data e Hyrjes në Fuqi ose një datë e mëvonshme që bihet dakord ndërmjet Marrësit dhe ISFD-së, Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, nuk i ka paraqitur ose nuk ka marrë masat për t'i paraqitur një kërkesë ISFD-së për të bërë Livrimin e Parë, ISFD-ja mund ta prishë këtë Marrëveshje duke i bërë njoftimin përkatës Marrësit.

3.3 Data e Mbylljes së Livrimit: Huaja dhe Granti tërhiqen plotësisht nga Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes ose një datë tjetër e mëvonshme që bihet dakord ndërmjet Marrësit dhe ISFD-së ("Data e Mbylljes së Livrimit"). Nëse një pjesë e Huas ose Grantit nuk përdoret deri në Datën e Mbylljes së Livrimit, ISFD-ja mund të anulojë pjesën që nuk është përdorur deri në atë datë.

3.4 Përdorimi i Shumave të Huas dhe Grantit: Të gjitha shumat e tërhequra nga Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, nga Huaja dhe Granti përdoren vetëm për qëllimet e Projektit të financuar nga ISFD-ja, duke zbatuar në masën më të gjerë të mundshme, mënyrat islamike të financimit, duke përfshirë pa u kufizuar në *murabaha*, (shitja me këste), *ijara*-n (lisingu), *salam*. Marrësi merr përsipër të sigurojë që shumat e Huas dhe Shuma e Grantit të mos përdoret për të financuar ndonjë shpenzim në lidhje me të cilin ISFD-ja konstaton se ka implikime të praktikave korruptive, mashtrimi, të fshehta, të detyruara ose penguese të përfaqësuesve të Marrësit ose një përfituesi tjetër të shumave të Huas dhe Shumës së Grantit, dhe Marrësi nuk ka ndërmarrë masa në kohë dhe të përshtatshme, të pranueshme për ISFD-në për të trajtuar këto praktika kur këto ndodhin. Për qëllimet e këtij seksioni:

"Praktikë korruptive": është ofrimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale tjetër;

"Praktikë mashtrimi": është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim, e cila çorienton ose përpiqet të çorientojë me dashje ose nga pakujdesia një palë për të përfutur një përfitim financiar ose tjetër ose të mënjanojë një detyrim;

"Praktikë detyruese": është çdo veprim ose mosveprim cenimi ose dëmtimi, ose rreziku për të

cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, një Palë ose pasurinë e palës për të ndikuar në mënyrë të parregullt veprimet e një Pale.

"Praktikë e fshehtë": është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve e përcaktuar për të arritur një qëllim të parregullt, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të parregullt të veprimeve të një Pale tjetër.

"Praktikë penguese" është:

i) prishja, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e provave të rëndësishme për hetimin ose bërja e deklarimeve të rreme para hetuesve me qëllim që të pengohet në mënyrë të konsiderueshme hetimi i IDB-së për akuzat e praktikës korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta; dhe/ose kërcënimi, ngacmimi ose trembja e një pale për ta penguar atë në deklarimin e njohurive të saj për çështjet e rëndësishme për hetimin ose në ndjekjen e hetimit; ose

ii) veprimet që synojnë të pengojnë në mënyrë të konsiderueshme marrjen nga ISFD-ja të informacionit të kërkuar nga kontrata në lidhje me hetimin e IDB-së të akuzave për praktika korruptive, mashtruese, detyruese ose të fshehta.

3.5 Mënyra e pagesës: Disbursimet bëhen në Llogarinë e Posaçme në pajtim me seksionin 3.8 më poshtë.

3.6 Marrësi merr masa që Partneri i Mikrofinancës të lidhë marrëveshje mikrofinance me Përfituesit Fundorë sipas termave dhe kushteve të parashikuara në aneksin V dhe pa cenuar dhe kufizuar detyrimet e Marrësit.

3.7 Pa cenuar seksionin 3.6 të më sipër, Marrësi shkakton që Partneri i Mikrofinancës të lidhë Marrëveshje të Mikrohuave (duke zbatuar në masën më të gjerë të mundshme *muraba*-në, *salaam*-in, lisingun, shitjen me këste dhe *istina'a*-n ose një mënyrë tjetër të pranueshme islamike të financimit) me Përfituesit Fundorë. Marrëveshjet e Mikrohuas (nëse është e mundur *murabaha*, *salaam*, *lisingu*, shitja me këste dhe *istina'a*-n ose një mënyrë tjetër të pranueshme Islamike të financimit) përcaktohen në monedhën lokale. Format i Marrëveshjes të Nen-Huazimit dhe Marrëveshjeve të Mikrohuadhënies (nëse është e mundur *murabaha*, *salaam*, *lizingu*, shitja me këste dhe *istina'a*-n ose një mënyrë tjetër të pranueshme islamike të financimit) do jetë në formën dhe me termat dhe kushtet e pranueshme për ISFD-në dhe bëhet pa cenuar dhe pa kufizuar detyrimet e Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

3.8 Llogaria e veçantë: Një llogari speciale do të hapet për Huan dhe një llogari e posaçme për Grantin në emër të Projektit nga Partneri i Mikrofinancës në dollarë amerikanë. Shumat fillestare dhe pasuese të depozituara në llogaritë e posaçme bazohen në planin vjetor të punës të Partnerit të Mikrofinancës për përdorimin e Huas dhe Grantit.

Neni 4 Pagesat

4.1 Amortizimi: Marrësi e shlyen Shumën Principale në 10 (dhjetë) vjet, duke përfshirë 3 (tre) vjet periudhë pa pagese principali, duke filluar nga data e kësaj Marrëveshjeje, në 14 (katërmëdhjetë) kështe gjashtëmujore dhe të njëpasnjëshme sipas parashikimit në grafikun A të aneksit II.

4.2 Tarifa e shërbimit: Marrësi i paguan ISFD-së një tarifë shërbimi në një shumë që aktualisht vlerësohet si më poshtë:

a) ID131,040.00 (njëqind e tridhjetë e një mijë e dyzet dinarë islamikë) në mënyrën e parashikuar në aneksin II(B) për Huan e IDB-së;

b) 49,140.00 USD (dyzet e nëntë mijë e njëqind e dyzet dollarë amerikanë) në mënyrën e parashikuar në aneksin II(B) për Huan e ISFD-së.

4.3 Kuptohet dhe është rënë dakord ndërmjet Palëve që shumat fillestare e Tarifës së Shërbimit të përmendur

Dollarë amerikanë
A/c Nr.:
1591,11
Gulf International Bank (UK) Ltd
One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Kodi Swift: SINTGB2L
Numrat e faksit: 8812261/2 Saudi G
A/c Nr.: B 10507
Arab Banking Corporation
P.O.Box: 5698, Manama, Bahrain
Nr. i faksit 9385,9431/2/3,9442 ABCBAH BN

Pound/stërlina
A/c Nr.:
GB13SINT60928000159137
Gulf International Bank (UK) Ltd
One Knightsbridge
London SW1X 7XS
United Kingdom
Teleks No. 8812261/2
Kodi Swift: GULF GB2L

Euro
A/c. Nr.:
FR7643899000019696500151088
Union de Banques Arabes et Francaises (UBAF)
92523 Paris, Neuilly Cedex
France
Nr. teleksi: 610334 UBAF
Kodi Swift: UBAFRPPXXX

4.7 Nëse një pagesë bëhet e kërkueshme në një ditë në të cilën bankat nuk janë zyrtarisht të hapura për veprime në vendin ku duhet të kryhet pagesa nga Marrësi në monedhën përkatëse ose në Republikën e Shqipërisë, kjo pagesë bëhet në ditën pasuese në të cilën këto banka janë të hapura për veprime.

4.8 Pagesa e vonuar: Nëse Marrësi nuk paguan një shumë të kërkueshme sipas grafikut përfundimtar të Shlyerjes së Principalit dhe Grafikut përfundimtar të Shlyerjes së Tarifës së Shërbimit, në datën e kërkueshme, Marrësi:

i) në pajtim me Parimet e Shari'ah Islamik, e kompenzon ISFD-në për çdo humbje, dëm, kosto dhe shpenzim faktik të arsyeshem që është dokumentuar rregullisht (duke përfshirë, pa u kufizuar në koston dhe shpenzimet ligjore dhe të agjentit) që pëson ISFD-ja si rezultat i vonesës së pagesës për ISFD-në.

ii) Një kamatëvonesë në lidhje me shumën e prapambetur, ku kjo kamatëvonesë llogaritet dhe zbatohet si një shumë e përcaktuar nga ISFD-ja pas zbatimit të formulës së treguar më poshtë:

A × B × C Ku: "A" është shumta e kësaj shume të papaguar;
360 "B" është 1% në vit; dhe
"C" është numri i ditëve nga dhe duke përfshirë këtë datë të kërkueshme deri ne/dhe duke përfshirë

në seksionin 4.2 nuk është gjë tjetër veçse vlerësimi i bazuar në prezumimin e periudhës së zbatimit dhe periudhën e livrimit të shumës së plotë të Huas që parashikohet këtu. Më tej është rënë dakord që shumta faktike e Tarifës së Shërbimit llogaritet pas zbatimit të Projektit, me kusht që shumta faktike e llogaritur në këtë mënyrë të mos i kalojë 2% (dy për qind) të Shumës Principale kur llogaritet me bazë vjetore.

4.4 Tarifa e shërbimit akumulohet nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

4.5 Vendet e pagesave: Çdo pagesë, duke përfshirë shlyerjen e Shumës Principale, konsiderohet të jetë bërë rregullisht kur fondet që përbëjnë këto pagesa kreditohen në një llogari të treguar për këtë qëllim nga ISFD-ja.

4.6 Pa cenuar përgjithësimin e dispozitave të seksionit 4.3, çdo pagesë si më poshtë konsiderohet të jetë kryer rregullisht nëse një prej bankave të mëposhtme i konfirmon ISFD-së marrjen e një pagese të tillë në një prej llogarive të mëposhtme, nëse pagesa bëhet në:

datën e pagesës faktike (para ose pas vendimit).

ISFD-ja, pas zbritjes së të gjithë koston dhe shpenzimeve faktike të shkaktuara, paguan çdo shumë të marrë në pajtim me këtë seksion në llogarinë Waqf të IDB-së si më poshtë:

Emri i llogarisë: the Bank Waqf Fund Account
A/c. Nr.: 0000 100 102

Emri i Bankës: The British Arab Commercial Bank
Kodi Swift: BACMGB2L
IBAN: GB69 BACM 4051 3200 100 102

Neni 5

Anulimi dhe pezullimi i shumës së huas dhe grantit

5.1 Anulimi nga Marrësi: Në pajtim me seksionin 5.4, Marrësi mund t'i kërkojë ISFD-së të anulojë Huan dhe Grantin ose një pjesë të tyre.

5.2 Pezullimi nga ISFD-ja: ISFD-ja, nëpërmjet njoftimit drejtuar Marrësit, mund të pezullojë Shumën e Huas dhe Grantit ose një pjesë të tyre në një nga rastet e mëposhtme:

i) Mospërmbushja nga Marrësi i detyrimeve të tij për të paguar Shumën Principale, Tarifën e Shërbimit ose një shumë tjetër të kërkueshme në pajtim me këtë Marrëveshje ose një marrëveshje tjetër financimi

ndërmjet ISFD-së (ose një institucioni tjetër filial i Grupit IDB) dhe Marrësit;

ii) Marrësi ka shkelur një angazhim ose detyrim të marrë përsipër sipas kësaj Marrëveshjeje ose nuk ka përmbushur një detyrim tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje;

iii) ISFD-ja (ose një institucion tjetër filial i grupit IDB) ka pezulluar të gjithë ose një pjesë të së drejtës së Marrësit të bëjë tërheqje sipas një marrëveshjeje financimi me ISFD-në (ose një institucion tjetër filial i grupit IDB) për shkak të mospërmbushjes nga Marrësi i detyrimeve të tij sipas një marrëveshjeje të tillë;

iv) ISFD-ja (ose një institucion tjetër filial i grupit IDB) ka pezulluar të gjithë ose një pjesë të së drejtës së Marrësit, sipas një marrëveshjeje financimi të garantuar nga Marrësi, të bëjë tërheqje nga Shuma e Huas për shkak të mospërmbushjes nga Marrësi i detyrimeve të tij sipas një marrëveshjeje të tillë;

v) Ka lindur një situatë e jashtëzakonshme, e cila:

a) e bën të pamundur që projekti të realizohet nga Marrësi; ose

b) pengon arritjen e qëllimeve për të cilat është lidhur kjo Marrëveshje;

vi) Anëtarësia e Shqipërisë në IDB është pezulluar ose ka përfunduar;

vii) Një përfaqësim i bërë nga Marrësi në pajtim me Marrëveshjen ose një deklaram i dhënë në lidhje me të dhe që synohet të merret për bazë nga ISFD-ja për dhënien e Shumës së Huas dhe Grantit është i pasaktë në një aspekt material;

E drejta e Marrësit për të bërë tërheqje vazhdon të jetë e pezulluar plotësisht ose pjesërisht, sipas rastit, derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë shkaktuar pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa ISFD-ja të ketë njoftuar Marrësin që e drejta e tij për të bërë tërheqje është rivendosur, cilado të ndodhë më parë; megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi të tillë rivendosjeje, e drejta për të bërë tërheqje rivendoset vetëm në masën dhe në pajtim me kushtet e specifikuar në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk ndikon ose cenon ndonjë të drejtë, tagër apo mjet mbrojtës të ISFD-së në lidhje me një ngjarje tjetër ose pasuese të përshkruar në këtë seksion.

5.3 Anulimi nga ISFD-ja: ISFD-ja, nëpërmjet njoftimit drejtuar Marrësit, mund të pezullojë Huan dhe Grantin ose një pjesë të tyre, nëse:

i) E drejta e Marrësit për të bërë tërheqje është pezulluar në lidhje me një pjesë të Huave dhe Grantit për një periudhë të pandërprerë prej tridhjetë ditësh; ose

ii) në çdo moment nëse ISFD-ja përcakton, pas konsultimeve me Marrësin, që çdo pjesë e kësaj shume nuk kërkohet për të financuar koston e Projektit që financohet nga shumat e Huave dhe Grantit; ose

iii) një pjesë e Huave dhe Grantit mbeten të

patërhequra pas Datës së Mbylljes së Tërheqjes, sipas specifikimit në seksionin 3.3.

5.4 Asnjë anulim apo pezullim nga ISFD-ja nuk zbatohet për shumat që i nënshtrohen një angazhimi të veçantë të ndërmarrë nga ISFD-ja në pajtim me seksionin 5.8 të Kushteve të Përgjithshme, përveç kur përcaktohet shprehimisht në këtë angazhim.

5.5 Pavarësisht anulimit apo pezullimit, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes mbeten në fuqi të plotë.

Neni 6

Prishja e marrëveshjes

6.1 Marrësi mund t'i kërkojë ISFD-së të prishë Marrëveshjen dhe të anulojë Huat dhe Grantin ose një pjesë të tyre në çdo kohë para kërkesës për Livrimin e Parë.

6.2 ISFD-ja, nëpërmjet njoftimit drejtuar Marrësit, mund të pezullojë ose prishë këtë Marrëveshje në një nga rastet e mëposhtme:

a) Ka ndodhur dhe po vazhdon një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve;

b) Ka ndodhur dhe po vazhdon një Efekt Material Negativ.

6.3 Në rastin e pezullimit, Marrëveshja vazhdon të jetë e pezulluar derisa ngjarja ose ngjarjet që kanë shkaktuar pezullimin të kenë pushuar së ekzistuari ose derisa ISFD-ja të ketë njoftuar Marrësin që angazhimi i ISFD-së për të ofruar Huat dhe Grantin është rivendosur, cilado të ndodhë më parë; megjithatë, me kusht që në rastin e një njoftimi të tillë rivendosjeje, angazhimi për të ofruar Huat dhe Grantin rivendoset vetëm në masën dhe në pajtim me kushtet e specifikuar në një njoftim të tillë, dhe asnjë njoftim i tillë nuk ndikon ose cenon ndonjë të drejtë, tagër apo mjet mbrojtës të ISFD-së në lidhje me një ngjarje tjetër ose pasuese të përshkruar në këtë seksion.

6.4 Nëse kjo Marrëveshje prishet në pajtim me këtë seksion, ISFD-ja, me njoftim me shkrim, mund të kërkojë nga Marrësi pagesën e të gjitha livrimeve dhe çdo kostoje tjetër të justifikuar të shkaktuar për shkak të zgjidhjes së parakohshme.

6.5 As Marrësi dhe as ISFD-ja nuk ka ndonjë detyrim tjetër kundrejt njëri-tjetrit nga data e zgjidhjes së Marrëveshjes sipas seksioneve 6.1, 6.2 ose 6.3, me kusht që kjo zgjidhje të mos ndikojë asnjë detyrim të shkaktuar ose të drejtë të përfutur nga ndonjë prej palëve para zgjidhjes, veçanërisht, Marrësi nuk lirohet nga pagesa për ISFD-në të shumave të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Ekzekutimi i projektit

7.1 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, merr përsipër:

i) të ekzekutojë Projektin dhe të zbatojë operacionet dhe punët me kujdesin dhe eficiencën e duhur dhe në

pajtim me praktikat e qëndrueshme administrative, financiare dhe ekonomike, nën mbikëqyrjen e menaxhimit dhe personelit të kualifikuar dhe me përvojë dhe në pajtim me grafikët e investimit, buxhetet, planet dhe specifikimet në lidhje me Projektin të paraqitur dhe të aprovuar nga ISFD-ja;

ii) të paraqesë ISFD-së për aprovim, dhe me ato hollësi që ISFD-ja kërkon në mënyrë të arsyeshme, çdo modifikim të rëndësishëm të parashikuar në buxhet, plane dhe specifikime të Projektit (duke përfshirë planet e punës), si dhe çdo ndryshim thelbësor në çdo kontratë shërbimesh ose prokurime mallrash në lidhje me ekzekutimin e Projektit.

7.2 Pa asnjë kufizim të asnjë prej detyrimeve të tjera sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrësi i lejon ISFD-së një kohë të mjaftueshme për të komentuar çdo ndryshim të konsiderueshëm ose çdo shtyrje afati të parashikuar në çdo kontratë shërbimesh ose prokurimi mallrash në lidhje me zbatimin e Projektit.

Neni 8

Parakushte shtesë para disbursimit nga ISFD-ja

Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, para paraqitjes së kërkesës së parë për tërheqje, cakton procedurën që propozon të ndjekë ose do të marrë masa të ndiqet për prokurimin në pajtim me seksionet 2.2 dhe 9.2 të kësaj Marrëveshjeje dhe do të marrë për këtë aprovimin e ISFD-së.

Neni 9

Detyrime të veçanta

9.1 Marrësi vë në dispozicion, në kohën që është e nevojshme, të gjitha shumat duke përfshirë shumat e nevojshme për koston e monedhës lokale dhe tejkallimet e koston që kërkojnë për kryerjen dhe përfundimin e Projektit, me termat dhe kushtet e pranueshme për ISFD-në.

9.2 Përveç kur ISFD-ja bie dakord ndryshe, të gjitha kontratat e financuara nga shumat e Huas dhe Grantit për zbatimin e Projektit jepen në pajtim me Udhëzimet e Prokurimit si më poshtë:

- i) Mallrat prokurohen me Blerje të Brendshme;
- ii) Shërbimet kryhen nëpërmjet një liste të kufizuar të Firmave të Brendshme; dhe
- iii) Shërbimet Financiare të Auditimit kryhen nëpërmjet një liste të kufizuar të Firmave të Brendshme.

9.3 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, i jep ISFD-së, menjëherë dhe me pëlqimin e Partnerit të Mikrofinancës, studimet, planet dhe specifikimet për Projektin, grafikun e zbatimit të tij dhe çdo modifikim të konsiderueshëm të kryer më vonë, me ato hollësi që ISFD-ja kërkon herë pas here.

9.4 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, krijon dhe mban regjistrat të përshtatshme për të identifikuar përdorimin e të fondeve të Huas dhe Grantit, për të regjistruar përparimin e Projektit dhe për të reflektuar, në pajtim me praktikat e qëndrueshme

financiare të mbajtura në mënyrë të njëtrajtshme, operacionet dhe gjendjen financiare.

9.5 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, jep të gjithë mundësinë e arsyeshme për përfaqësuesit e ISFD-së të bëjë vizita për qëllimet në lidhje me Huat dhe Grantin, për të takuar Përfituesit Fundorë dhe të inspektojnë Projektin, mallrat dhe çdo regjistrat dhe dokument përkatës; dhe i jep ISFD-së të gjithë atë informacion që ISFD-ja kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimin e shumave të Huas dhe Grantit, Projektin dhe operacionet dhe gjendjen financiare të Partnerit të Mikrofinancës.

9.6 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, ndërmerr të gjitha veprimet e duhura nga ana e tij për të ekzekutuar Projektin dhe nuk ndërmerr apo lejon ndërmarrjen e ndonjë veprimi që do të pengonte ose ndërhynte në ekzekutimin ose operimin e Projektit apo përmbushjen e ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

9.7 Të gjitha dokumentet, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme të ISFD-së konsiderohen nga ISFD-ja dhe Marrësi si çështje konfidenciale.

9.8 Të gjitha taksat, detyrimet, tarifat kostot dhe detyrimet e këmbimit në lidhje me Huan ose Grantin (duke përfshirë tarifat ligjore) mbulohen nga Marrësi.

9.9 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, siguron që në zbatimin e Projektit, IDB-ja dhe pjesëmarrjen e ISFD-së të njihen, ndërmjet masave të tjera, duke vendosur logot në të gjithë kantieret dhe duke shënuar në të gjitha pajisjet, automjetet dhe dokumentet “Projekt i Financuar nga Banka Islamike për Zhvillim dhe/ose Fondi Islamik i Solidaritetit për Zhvillimin”.

9.10 Çdo vonesë, mospagesë, pezullim, anulim dhe shkelje e një prej Marrëveshjeve të Mikro-Huadhënies nuk është dëmtuese për interesin e ISFD-së dhe nuk ndikon në asnjë të drejtë që ISFD-ja mund të ketë sipas kësaj Marrëveshjeje.

9.11 Marrësi, gjatë nënhuazimit të Partnerit të Mikrofinancës, përmbush detyrimet financiare të parashikuara në Aneksin IV.

9.12 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, gjatë gjithë kohës së zbatimit të Projektit, përmbush detyrimet e financimit të parashikuara në aneksin V.

9.13 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, siguron ose merr masa për sigurimin e përfshirjes së dispozitave të pranueshme për ISFD-në kundër korrupsionit dhe mashtrimit në të gjitha dokumentet dhe kontratat e ofertimit, duke përfshirë dispozita që specifikojnë të drejtën e ISFD-së për të audituar dhe shqyrtuar regjistrat dhe llogaritë e agjencive zbatuese dhe ekzekutuese dhe të gjithë kontraktorëve, furnitorëve, konsulentëve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve që kanë të bëjnë me Projektin.

9.14 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, krijon dhe mban regjistrat të përshtatshme:

- i) për identifikimin e mallrave dhe/ose shërbimeve të

financuara nga shumat e Huas dhe Grantit;

ii) për deklarimin e përdorimit të tyre në Projekt;

iii) për regjistrimin e përparimit të Projektit; dhe

iv) për të reflektuar në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare të mbajtura në mënyrë të njëtrajtshme, operacionet dhe gjendjen financiare të Partnerit të Mikrofinancës.

9.15 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikro-financës, jep të gjithë mundësinë e arsyeshme për përfaqësuesit e ISFD-së të bëjnë vizita për qëllimet në lidhje me Huat dhe Grantin, dhe të inspektojnë Projektin, mallrat dhe çdo regjistrë dhe dokument përkatës; dhe i jep ISFD-së të gjithë atë informacion që ISFD-ja kërkon në mënyrë të arsyeshme në lidhje me shpenzimin e shumave të Huas dhe Grantit, Projektin, mallrat dhe operacionet dhe gjendjen financiare të Partnerit të Mikrofinancës.

Neni 10

Raportet

10.1 Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikro-financës, dhe ISFD-ja bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar arritjen e qëllimeve të Huave dhe Grantit dhe, herë pas here me kërkesën e një pale, shkëmbejnë mendime nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në lidhje me çështjet për qëllimet e Huas dhe Grantit, përmbushjen nga Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

10.2 (a) Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikro-financës, merr përsipër të sigurojë paraqitjen tek ISFD-ja, me pranimin e kësaj të fundit dhe në momentet e specifikuar për secilin, raportet e mëposhtme:

i) brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas fundit të çdo tremujori kalendarik, ose brenda atyre afateve që mund të bien dakord palët, raportet për ekzekutimin e Projektit në atë mënyrë që ISFD-ja specifikon herë pas here;

ii) pasqyra financiare gjashtë mujore të paaudituar dhe vjetore të audituara;

iii) raportin për përmbushjen e detyrimeve financiare (sipas Marrëveshjes) duke përfshirë hollësitë e llogaritjes të përpjesëtimit, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve pas fundit të çdo semestri;

iv) listën e 20 (njëzet) ekspozimeve më të mëdha (duke përfshirë ekspozimet sipas huave, letrave të kreditit, garancive dhe investimeve të kapitalit të vet) ndaj klientëve dhe grupeve të biznesit (të ndryshme nga bankat), dhe kjo listë të përfshijë të gjitha ekspozimet ndaj këtyre klientëve dhe grupeve, dhe filialeve të tyre;

v) ato raporte të tjera që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme ISFD-ja në lidhje me zbatimin e Huas dhe Grantit të livruar dhe përparimin e Projektit;

vi) menjëherë pas përfundimit të Projektit por në

çdo rast jo më vonë se 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë pas datës së mbylljes së Projektit ose një datë të mëvonshme që mund të bihet dakord për këtë qëllim ndërmjet Marrësit, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, dhe ISFD-së, Marrësi, nëpërmjet Partnerit të Mikrofinancës, përgatit dhe i paraqet ISFD-së një raport përfundimi me atë objekt dhe ato hollësi që kërkon në mënyrë të arsyeshme ISFD-ja, mbi ekzekutimin dhe operimin fillestar të Projektit.

b) Dokumentet e përshkruara në këtë seksion vërtetohen, sipas zgjedhjes së ISFD-së, në atë mënyrë që kërkon në mënyrë të arsyeshme ISFD-ja.

Neni 11

Hyrja në fuqi

11.1 Kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi derisa dokumentet e mëposhtme t'i jepen ISFD-së:

i) Prova të pranueshme për ISFD-në që të tregojnë që nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Marrësit është autorizuar dhe/ose ratifikuar rregullisht nga Marrësi;

ii) Opinion ligjor të pranueshëm për ISFD-në që vjen nga autoriteti ligjor i Marrësit që përcakton se termat dhe kushtet e Marrëveshjes përbëjnë detyrime të ekzekutueshme dhe detyruese për Marrësin thelbësisht në formën e parashikuar në aneksin VI të kësaj Marrëveshjeje;

iii) Letër autorizimi nga Ministria e Financave për Bankën Qendrore të Republikës së Shqipërisë që udhëzon/autorizon Bankën Qendrore që pagesa nga Marrësi sipas kësaj Marrëveshjeje të kështjës të Shumës Principale dhe Tarifave të Shërbimit realizohet nga Banka Qendrore në datat në të cilat bëhen të kërkueshme; dhe

iv) Njohjen nga Banka Qendrore që tregon se ajo ka marrë këtë letër udhëzimi/autorizimi dhe që do të respektojë udhëzimet në përmbajtje të tij.

v) Një marrëveshje të nënshkruar për nënhuazimin e fondeve ndërmjet Marrësit dhe Partnerit të Mikrofinancës që deklaron që kostoja e financimit të kërkuar nga Partneri i Mikrofinancës nuk do të kalojë Tarifën e Shërbimit të caktuar nga ISFD-ja.

11.2 Nëse Marrëveshja nuk hyn në fuqi brenda 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve nga data e kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshja dhe të gjitha detyrimet e Palëve pushojnë së qeni në fuqi, përveç kur ISFD-ja, pas shqyrtimit të të gjithë shkaqeve të vonësës, cakton një datë të mëvonshme për qëllimet e këtij neni. ISFD-ja njofton menjëherë Marrësin për këtë datë të mëvonshme.

Neni 12

Përfaqësimet dhe garancitë

Marrësi përfaqëson që:

a) Ka fuqinë të lidhë këtë Marrëveshje dhe të përmbushë detyrimet sipas saj dhe të gjithë veprimet e kërkuara për të autorizuar ekzekutimin e kësaj

Marrëveshjeje dhe përmbushjen nga Marrësi i detyrimeve të veta sipas saj janë ndërmarrë rregullisht;

b) Detyrimet që shprehen të marra përsipër nga Marrësi në këtë Marrëveshje janë detyrime ligjore dhe të vlefshme, detyruese për Marrësin në pajtim me termat e saj;

c) Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje dhe përmbushja nga Marrësi i detyrimeve të veta sipas saj nuk përbëjnë dhe nuk do të përbëjnë ndonjë shkelje të një marrëveshjeje, traktati apo ligji;

d) Të gjitha aktet, kushtet dhe përbërësit (duke përfshirë pëlqimin për kontrollin e këmbimit) që kërkohen të kryhen, përmbushen dhe realizohen nga ligjet e Shqipërisë, me qëllim që:

i) t'i mundësojnë Marrësit të marrë ligjërisht përsipër dhe të përmbushë detyrimet e shprehura për t'u marrë përsipër prej tij në këtë Marrëveshje;

ii) të sigurojnë që detyrimet e shprehura për t'u marrë prej tij përsipër në këtë Marrëveshje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të ekzekutueshme; dhe

iii) ta bëjnë këtë Marrëveshje të pranueshme me prova në Shqipëri pa ndërmarrë hapa ose formalitete të tjera, janë përmbushur dhe realizuar në pajtim rigoroz me ligjet dhe Kushtetutën e Shqipërisë;

e) Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje që mund të ketë një efekt material negativ në gjendjen financiare të Marrësit;

f) Sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë në fuqi në datën e saj, pretendimet e ISFD-së kundrejt Marrësit sipas kësaj Marrëveshjeje renditen të paktën *pari passu* me pretendimet e të gjitha kreditorëve të tjerë të pasiguruar për çdo qenie në borxh të Marrësit.

Neni 13

Rastet e mospërmbushjes së detyrimeve

13.1 Nëse ka ndodhur një nga ngjarjet e specifikuar në këtë seksion dhe nuk ndërpritet, ISFD-ja, me njoftim drejtuar Marrësit, mund të deklarojë që i gjithi ose një pjesë e Huas ose Grantit të jetë i shlyeshëm dhe në një rast të tillë ky bëhet menjëherë i pagueshëm (pavarësisht parashikimeve në këtë Marrëveshje) pa njoftim të mëtejshëm:

i) mospërmbushja e detyrimeve nga Marrësi kundrejt ISFD-së, apo një filiali të ISFD-së sipas një marrëveshjeje të ndryshme nga kjo Marrëveshje;

ii) ka ndodhur një mospërmbushje nga Marrësi në pagesën e një shume të kërkueshme këtu, ose ndryshe, për ISFD-në, një prej filialeve të saj, dhe kjo mospërmbushje ka vazhduar për një periudhë prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh.

iii) një mospërmbushje, e ndryshme nga ajo e specifikuar në paragrafin (i) ka ndodhur në përmbushjen e një detyrimi të Marrësit dhe çdo mospërmbushje e tillë ka vazhduar për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh.

iv) një përfaqësim apo garanci i konfirmuar apo i

bërë nga Marrësi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Marrëveshjeje, çdo dokument i dhënë sipas kësaj marrëveshjeje ose në lidhje me një kërkesë për livrim sipas kësaj marrëveshjeje, është gjetur e pasaktë në aspektin material dhe vazhdon të jetë e pasaktë për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pas njoftimit të dhënë për këtë Marrësit nga ISFD-ja.

iv) një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është bërë e pavlefshme ose e paekzekutueshme;

13.2 Nëse ka ndodhur një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve ose një ngjarje e cila, me kalimin e kohës ose pas njoftimit dhe me kalimin e kohës do të bëhej një Rast i Mospërmbushjes së Detyrimeve, Marrësi i dërgon menjëherë njoftim ISFD-së për këtë me faks, duke përcaktuar natyrën e këtij Rasti të Mospërmbushjes së Detyrimeve ose një rasti tjetër dhe hapat që Marrësi po ndërmerr për ta korrigjuar.

13.3 Asnjë mënyrë veprimi dhe asnjë vonesë në ushtrimin ose mosushtrimin e një të drejte, tagri apo mjeti që i takon ISFD-së në rastin e një qenieje në mospërmbushje sipas kësaj Marrëveshjeje ose një marrëveshjeje tjetër nuk e cenon këtë të drejtë, tagër apo mjet dhe nuk interpretohet sikur hiqet dorë prej saj apo sikur kjo tolerohet; asnjë veprim i ISFD-së në lidhje me këtë qenie në mospërmbushje apo tolerim të saj nuk cenon apo dëmton ndonjë të drejtë, tagër apo mjet të ISFD-së në lidhje me një rast tjetër të mospërmbushjes së detyrimeve.

Neni 14

Ligji i zbatuar, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1 Ligji i zbatuar: Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në pajtim me parimet e Shariahut Islamik sipas deklaramit të Akademisë Islamike Fiqh të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik dhe të parashikuar në Standardet e Shari'a të publikuara nga

Organizata e Kontabilitetit dhe Auditimit për Institucionet Financiare Islamike (AAOIFI). Në rastin e një mospërputhjeje ndërmjet ligjeve të Shqipërisë dhe Parimeve të Shariahut Islamik mbizotërojnë Parimet e Shariahut Islamik.

14.2 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:

a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve dhe çdo pretendim nga një Palë e tillë ndaj Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk zgjidhet me marrëveshje ndërmjet palëve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit nga një Palë drejtuar Palës tjetër, vendoset përfundimisht nga një panel arbitrazhi në pajtim me rregullat dhe procedurat e Qendrës Ndërkombëtare Islame për Pajtim dhe Arbitrazh në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe.

b) Nëse brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi kopjet e vendimit t'u jenë dhënë Palëve, vendimi nuk zbatohet, çdo Palë mund të kërkojë urdhër ekzekutimi ose të fillojë një procedurë për të

ekzekutuar vendimin në çdo gjykatë me juridiksion kompetent ndaj palës tjetër, mund të zbatohet këtë vendim me ekzekutim të detyruar ose mund të ndjekë një mjet tjetër kundrejt Palës tjetër për zbatimin e vendimit ose dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

c) Dorëzimi i çdo njoftimi apo padie në lidhje me një procedurë sipas seksionit 14.2(a) ose në lidhje me një procedurë për ekzekutimin e një vendimi të dhënë në pajtim me seksionin 14.2(a) mund të bëhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 15.4. Palët mund të heqin dorë nga një ose të gjitha kërkesat për dorëzimin e njoftimit apo padisë.

d) Marrësi përgjithësisht jep pëlqimin në lidhje me çdo padi ose procedim që rrjedh nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje për dhënien e mbrojtjes ose lëshimin e një urdhri në lidhje me një veprim ose procedim të tillë duke përfshirë, pa kufizim, nxjerrjen, zbatimin ose ekzekutimin e detyruar ndaj çdo prone (pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i destinuar i saj) të çdo urdhri apo vendimi arbitrazhi ose gjyqësor që mund të nxirret ose jepet për këtë padi ose procedim.

e) Në masën që Marrësi mund të pretendojë në një juridiksion për vete ose sendet pasurore të tij imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi (paraprak apo si ekzekutim, para një vendimi arbitrazhi apo gjyqësor ose ndryshe) apo nga një gjykim tjetër ose në masën që në një juridiksion të tillë mund t'i vishet atij vetë ose sendeve pasurore të tij ky imunitet (i pretenduar apo jo), Marrësi bie dakord në mënyrë të pakthyeshme për të mos e pretenduar dhe në këtë mënyrë heq dorë nga ky imunitet.

f) Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij seksioni 14.2, ISFD-ja mund të nisë proces gjyqësor në një gjykatë në Shqipëri ose në një juridiksion tjetër në diskrecionin e plotë të ISFD-së, nëse Marrësi nuk i paguan ISFD-së një shumë sipas kësaj Marrëveshjeje. Kjo dispozitë është vetëm për përfitimin e ISFD-së.

Neni 15

Dispozita të ndryshme

15.1 Përfaqësues të Autorizuar: Ministri i Financave i Marrësit dhe ai person apo persona që ai cakton me shkrim konsiderohen si përfaqësues të autorizuar të Marrësit për qëllimet e seksionit 10.03 të Kushteve të Përgjithshme. Marrësi i jep ISFD-së prova dokumentare për autoritetin e personit ose personave që në emër të Marrësit e nënshkruajnë këtë Marrëveshje ose ndërmarrin një veprim tjetër apo nënshkruajnë një dokument tjetër të kërkuar apo lejuar të ndërmerret sipas kësaj Marrëveshjeje nga Marrësi dhe ekzemplarët e vërtetuar të firmave të këtij personi apo personave.

15.2 Heqja dorë: Mosushtimi ose mostheksimi nga ISFD-ja i të drejtave të saj sipas kësaj Marrëveshjeje ose vonesa për këto apo mosushtimi

apo mostheksimi i një mjeti që ajo mund të ketë ndaj Marrësit ose një vonesë për këtë nuk e cenon këtë të drejtë ose mjet dhe nuk interpretohet si heqje dorë nga kjo e drejtë ose mjet.

15.3 Data e Marrëveshjes: Për të gjitha qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, data e saj është ajo që shfaqet në preambulën e saj.

15.4 Njoftime dhe kërkesa: Çdo njoftim apo kërkesë që duhet t'i paraqitet apo bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje një pale bëhet me shkrim dhe mund të jepet me letër të autorizuar SWIFT ose me telefaks. Një njoftim ose kërkesë e tillë konsiderohet të jetë paraqitur ose bërë rregullisht nëse dorëzohet dorazi, me postë ose telefaks në adresën që kërkohet ose lejohet të jepet apo paraqitet Palës në adresën e saj të specifikuar në seksionin 15.05 ose në një adresë tjetër që i adresuari ka përcaktuar nëpërmjet një njoftimi drejtuar Palës që bën këtë njoftim ose kërkesë.

15.5 Të adresuarit: Adresat e mëposhtme specifikohen për qëllimet e seksionit 15.4:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 1

Tiranë/ Shqipëri

Tel: +355 4 228 405

Faks: +355 4 228 494

Për Partnerin e Mikrofinancës:

Shoqëria e Parë Shqiptare Financiare për Zhvillim

Str. "Dervish Hima", nr. 4

Tiranë/ Shqipëri

Tel: +355 4 2232937

Faks: +355 4 2232937

Për Bankën Islamike për Zhvillim:

P.O. Box 5925

Jeddah – 21432

Kingdom of Saudi Arabia

Faks: +966 2 6366871

Tel: +966 2 6361400

Swift: ISLDSAJEXXX

(FUNDI I NENEVE)

FAQJA E NËNSHKRIMIT

Në dëshmi të kësaj, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar kanë nënshkruar këtë Marrëveshje, në gjuhën angleze, në lidhje me Projektin e Mikrofinancës në Shqipëri për një Hua të ISFD-së në një shumë që nuk kalon 1,000,000 USD /- (një milion dollarë amerikanë) dhe një Hua të IDB-së që nuk kalon ID 2,670,000/- (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë dinarë islamikë) dhe Grantin e Asistencës Teknike në një shumë që nuk kalon ID 200,000/- (dyqind mijë dinarë islamikë) në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

Për dhe në emër të

Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Emri:
Titulli:

Për dhe në emër të
Bankës Islamike për Zhvillim
(në cilësinë e saj dhe si administratore e
Fondit Islamik të Solidaritetit për Zhvillim)

Emri:
Titulli:

ANEKSI I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Informacion paraprak mbi Projektin:

1. Qëllimi i këtij projekti është ulja e varfërisë dhe papunësisë nëpërmjet nxitjes dhe inkurajimit të ndërmjetësve të qëndrueshëm financiarë, duke përfshirë rrjetet e Shoqatave Private të kursimeve dhe kredisë (SCA-të) për dhënie të mikrokredive në zonat urbane dhe rurale. Në mënyrë që të arrihet ky qëllim, projekti ka objektivat e mëposhtëm:

I. Mundësimi i burimeve të realizueshme & përfshirëse të mikrofinancës, duke financuar segmente të varfra të popullatës (veçanërisht gratë) që punojnë në sektorin bujqësor në zonat kryesisht rurale, malore dhe urbane të varfra të Shqipërisë.

II. Plotësimi i strategjisë së qeverisë për zbutjen e varfërisë, duke synuar rrethet/pjesët e varfra të largëta & të marginalizuara dhe mbështetja e institucioneve & fondeve lokale të mikrofinancës dhe shoqërisht të qëndrueshme.

Zona e Projektit: Projekti do të zbatohet në 14 rrethe të zgjedhur të Shqipërisë, veçanërisht në rajonet

malore në mbështetje të fermerëve të vegjël, të të varfërve ekonomikisht aktivë në të gjithë sektorin gjenerues të të ardhurave dhe sipërmarrësve të vegjël, veçanërisht gratë si në zonat urbane ashtu edhe rurale.

Komponentët e Projektit:

a) Skema e Mikrofinancës: Brenda këtij komponenti, do të krijohet një fond qarkullues për t'i dhënë hua agjencisë partnere, Shoqërisë së Parë Shqiptare Financiare për Zhvillimin (FAFDC) për dhënie të huave të mëtejshme përfituesve të caktuar.

b) Ndërtimi i Kapaciteteve dhe Vlerësimi (Granti i Asistencës Teknike): Brenda këtij komponenti, asistencë do t'ju jepet MFP-ve pjesëmarrëse për të forcuar kapacitetin e tyre për të trajtuar projektet e mikrofinancës në një mënyrë që përputhet me Shariahun.

c) Sondazhi dhe Vlerësimi Bazë (Granti i Asistencës Teknike): Granti do të mbulojë gjithashtu koston e ndërmarrjes së një studimi bazë për të vlerësuar gjendjen social-ekonomike të grupeve të caktuara, dhe bazuar në këtë studim, do të zhvillohen treguesit përkatës.

d) Vlerësimi i Mikrofinancës (Granti i Asistencës Teknike): Granti do të përdoret, gjithashtu, për të zhvilluar vlerësimin social dhe financiar (kredisë) të MFP-së pjesëmarrëse nga agjencitë e njohura të vlerësimit të mikrofinancës.

e) Audit: Audit i pavarur do të shqyrtojë fondin qarkullues, pasqyrën e shpenzimeve dhe gjendjen e përgjithshme të portofolit të projektit.

ANEKSI II(A) GRAFIK PARAPRAK I SHLYERJES SË PRINCIPALIT

Për huan IDB		
Numri	Datë	Shuma (ID)
1	31/12/2016	190.476,19
2	30/06/2017	190.476,19
3	31/12/2017	190.476,19
4	30/06/2018	190.476,19
5	31/12/2018	190.476,19
6	30/06/2019	190.476,19
7	31/12/2019	190.476,19
8	30/06/2020	190.476,19
9	31/12/2020	190.476,19
10	30/06/2021	190.476,19
11	31/12/2021	190.476,19

Për huan ISFD		
Numri	Datë	Shuma (USD)
1	31/12/2016	71.428,57
2	30/06/2017	71.428,57
3	31/12/2017	71.428,57
4	30/06/2018	71.428,57
5	31/12/2018	71.428,57
6	30/06/2019	71.428,57
7	31/12/2019	71.428,57
8	30/06/2020	71.428,57
9	31/12/2020	71.428,57
10	30/06/2021	71.428,57
11	31/12/2021	71.428,57

12	30/06/2022	190.476,19
13	31/12/2022	190.476,19
14	30/06/2023	190.476,19
Totali:		2.666.667,67

12	30/06/2022	71.428,57
13	31/12/2022	71.428,57
14	30/06/2023	71.428,57
Totali:		1,000,000.00

ANEKSI II(B) GRAFIK PARAPRAK I SHLYERJES SË TARIFËS SË SHËRBIMIT

Për huan IDB		
Numri	Datë	Shuma (ID)
1	31/12/2013	5.241,60
2	30/6/2014	8.736,00
3	31/12/2014	8.736,00
4	30/6/2015	8.736,00
5	31/12/2015	8.736,00
6	30/6/2016	8.736,00
7	31/12/2016	8.736,00
8	30/06/2017	7.338,24
9	31/12/2017	7.338,24
10	30/06/2018	7.338,24
11	31/12/2018	7.338,24
12	30/06/2019	7.338,24
13	31/12/2019	7.338,24
14	30/06/2020	7.338,24
15	31/12/2020	7.338,24
16	30/06/2021	7.338,24
17	31/12/2021	7.338,24
Totali:		131.040,00

Për huan ISFD		
Numri	Datë	Shuma (USD)
1	31/12/2013	1.965,60
2	30/6/2014	3.276,00
3	31/12/2014	3.276,00
4	30/6/2015	3.276,00
5	31/12/2015	3.276,00
6	30/6/2016	3.276,00
7	31/12/2016	3.276,00
8	30/06/2017	2.751,84
9	31/12/2017	2.751,84
10	30/06/2018	2.751,84
11	31/12/2018	2.751,84
12	30/06/2019	2.751,84
13	31/12/2019	2.751,84
14	30/06/2020	2.751,84
15	31/12/2020	2.751,84
16	30/06/2021	2.751,84
17	31/12/2021	2.751,84
Totali:		49.140,00

ANEKSI III TËRHEQJA E SHUMAVE TË HUAS DHE GRANTIT

Milionë USD

Komponentët	Kostoja e përgjithshme	IDB	%	ISFD	%	Granti i asistencës teknike	%	MFP	%
Skema e mikrofinancës	5,41	3,71	68.58%;	1,00	18.48%;	0,00	0.00%;	0,70	12.94%;
Ndërtim kapacitetesh / trajnim, Vlerësim i Mikrofinancës, Sondazhe të Bazës & Vlerësimit	0,30	0,00	0.00%;	0,00	0.00%;	0,30	100.00%;	0,00	0.00%;
Auditi financiar	0,05	0,05	100.00%;	0,00	0.00%;	0,00	0.00%;	0,00	0.00%;
Kostoja e përgjithshme bazë	5,76	3,76	65.28%;	1,00	17.36%;	0,30	5.21%;	0,70	12.15%;
Fond rezervë(5%)	0,24	0,24	100.00%;	0,00	0.00%;	0,00	0.00%;	0,00	0.00%;
Kostoja e përgjithshme e projektit	6,00	4,00	66.67%;	1,00	16.67%;	0,30	5.00%;	0,70	11.67%;

ANEKSI IV TERMAT DHE KUSHTET E NËNHUAZIMIT

1. Tarifat e nënhuazimit nuk kalojnë Tarifën e Shërbimit të caktuar nga ISFD-ja.
2. Nënhuazimi do të bëhet në USD.

ANEKSI V TERMAT DHE KUSHTET E MIKROFINANCIMIT

1. Gratë duhet të përbëjnë të paktën 50% të Përfituesve Fundorë.
2. 40% e portofolit të mikrofinancës është në sektorin bujqësor dhe blegtoral.
3. Skema e mikrofinancës zbatohet në zonat e identifikuar dhe të rëna dakord nga ISFD-ja.

ANEKSI VI OPINIONI LIGJOR I AUTORITETIT LIGJOR TË MARRËSHJES (Të vendoset në kokën e letrës)

Banka Islamike për Zhvillim
P.O. Box: 5925, Jeddah 21432
Kingdom of Saudi Arabia

Të nderuar zotërinj,

Në cilësinë time si Ministër i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë, në bazë të kompetencave të dhëna sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe duke qenë në zotërim të kompetencës së plotë për të dhënë Opinione Ligjore për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Republikën e Shqipërisë, vërtetoj që ky dokument përbën Opinionin Ligjor të dhënë në lidhje me Marrëveshjen e Huas dhe Asistencës Teknike (Granti) të datës ____/____/____H(____/____/____G) të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (në cilësinë e saj dhe si administratore e Fondit Islamik të Solidaritetit për Zhvillim) (“Banka”) dhe (“Marrëveshja”) për financimin e një projekti të mikrofinancës sipas përshkrimit në Aneksin-I të Marrëveshjes (“Projekti”), për një Hua të ISFD-së në një shumë që nuk kalon 1,000,000 USD /- (një milion dollarë amerikanë) dhe një Hua të IDB-së që nuk kalon ID2,670,000/- (dy milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë dinarë islamikë) dhe Grant të Asistencës Teknike në një shumë që nuk kalon ID 200,000/- (dyqind mijë dollarë islamikë)

Për qëllimin e këtij Opinioni Ligjor, unë kam shqyrtuar,

- i) një kopje të nënshkruar të Marrëveshjes;
- ii) autorizimin për të lidhur dhe nënshkruar Marrëveshjen;
- iii) të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet dhe të tjera të Republikës së Shqipërisë; dhe
- iv) ato dokumente dhe instrumente të tjera që unë i kam çmuar të arsyeshme.

Për pasojë, Unë jam i mendimit që kjo Marrëveshje e nënshkruar në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë me ***** ____/____/____H (____/____/____G).

a) është autorizuar, nënshkruar, dhënë dhe ratifikuar rregullisht me anë të çdo veprimi korporativ dhe qeveritar;

b) nuk kërkon ndonjë autorizim, pëlqim, licencë, përjashtim apo heqje dorë tjetër;

c) nuk shkel ndonjë dispozitë të Kushtetutës, ndonjë ligj, rregull, rregullore, urdher apo dekret të Republikës së Shqipërisë;

dhe kështu përbën detyrime detyruese për Republikën e Shqipërisë në pajtim me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje.

Në masën që Republika e Shqipërisë mund të pretendojë në një juridiksion për vete ose sendet pasurore të saj imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi (paraparak apo si ekzekutim, para një vendimi

arbitrazhi apo gjyqësor ose ndryshe) apo nga një gjykim tjetër ose në masën që në një juridiksion të tillë mund t'i vishet asaj vetë ose sendeve pasurore të saj ky imunitet (i pretenduar apo jo), Republika e Shqipërisë bie dakord në mënyrë të pakthyeshme për të mos e pretenduar dhe në këtë mënyrë heq dorë nga ky imunitet.

Në çdo rast Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet për ekzekutimin në lidhje me:

a) “Ambientet e misionit” të tashme ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë apo një agjenci ose strukturë e saj;

b) një pasuri e patundshme që hyn në sferën e nenit 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr 8743, datë 22.2.2001, “Mbi pasuritë e patundshme shtetërore”;

c) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare së drejtës publike të nënshkruara prej saj.

Deklaruar sa më sipër, unë nuk shpreh asnjë mendim në lidhje me ligjet e ndonjë juridiksioni tjetër përveç atyre të Republikës së Shqipërisë.

Hartuar në ***** më ____/____/____H (që përputhet me ____/____/____G).

Me respekt,

Nënshkrimi/emri/pozicioni
